



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

KUMTESË
10 korrik 2018

#DrejtësipërAntigonën

Nesër me **11 korrik**, në ora **10:00**, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) organizon protestë paqësore para objektit të Gjykatës në Rahovec, për të kërkuar drejtësi për Antigonën. Pasi që institucionet e drejtësisë nuk po ndërmerrnin masat e duhura, pas reagimeve të shumta, RrGK angazhoi avokaten Fehmije Gashi Bytyqi që të përfaqësonte familjen e Antigonës.

Përmes kësaj proteste kërkojmë urgjentisht reagim adekuat nga Gjykata Themelore në Rahovec për rastin e të ndjerës Antigona Morina dhe dënim meritore për shkaktarin e vdekjes së saj, Hilmi Zenën. I njejtë ishte shpallur i pafajshëm nga po kjo gjykatë, ndërsa ankesa e bërë nga Prokuroria pas atij vendimi ishte zhdukur nga zyrtarët në Gjykatën Themelore në Rahovec.

Andaj, RrGK kërkon nga drejtësia kosovare llogaridhënie dhe seriozitet në trajtimin e këtij rasti por edhe rasteve tjera të ngjashme, në përputhshmëri me Kodin Penal të Kosovës.

Ju rikujtojmë që e ndjera kishte vdekur 6 vite më parë për shkak të hemorragjisë së vazhdueshme, tri ditë pas martesës. Atëkohë bashkëshorti i saj, Hilmi Zena, përpos që nuk i kishte ofruar ndihmë mjekësore, ka përkeqësuar gjendjen e saj duke vazhduar marrëdhëniet seksuale me të.

Për më shumë informata rreth qëndrimit të RrGK për këtë rast, ju lutemi lexoni kumtesën e plotë që RrGK ka dërguar me 19 mars, në vegzën në vazhdim: <http://www.womensnetwork.org/documents/20180319144025185.pdf>.

Angazhimi i avokates Fehmije Gashi Bytyqi është mundësuar përmes Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Shënim: Transporti sigurohet nga RrGK. Nisja e autobusit nga Prishtina për në Rahovec do të bëhet në ora **7:45** tek parkingu përballë RTV 21, ndërsa kthimi për në Prishtinë në ora **13:00**.

Rrjeti i Grave të Kosovës është rrjet i më shumë se 130 organizatave të ndryshme të të drejtave të grave në gjithë Kosovën që synon të mbrojë, promovojë dhe mbështesë të drejtat e grave dhe vajzave.